

KONTRATE THEMELIMI I SHOQERISE "DULE" SHPK.



Sot me daten 10.09. 1998, ne Tirane, Shqiperi, une Mitat DULE. i biri Nimetit, lindur me 9.12.1966 dhe banues ne Zhame Lushnje, me pasaporten Nr.050232 dhe Gazeli DULE, i biri Nimetit, lindur me 20.06.1964 dhe banues ne Zhame Lushnje, me pasaporten Nr.0786145, mbeshtetur ne Ligjin Nr.7638, date 11 Nentor 1992 " Per shoqerite tregetare " dhe ne Legjislacionin Shqipetar ne pergjithesi, vendosem per sa me poshte vijon:

Neni 1

Te themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, per te zhvilluar veprimtari tregetare si import-eksport dhe transport te mallrave industriale, ushqimore, materiale ndertimi, paisje higjeno-sanitare etj. dhe tregetimin e tyre, ne perputhje me Kap.4 te Ligjit Nr. 7638, date 11 Nentor 1992 " Per shoqerite tregetare".

Neni 2

Shoqeria do te emertohet " DULE" SH.P.K.

Neni 3

Shoqeria ka seline ligjore ne Durres

Ortaket themelues, kur e gjykojne te arsyeshme mund te vendosin te themelojne dege dhe agjenci brenda dhe jashte vendit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise, eshte:

Te zhvilloje veprimtari ekonomike dhe tregetare brenda ligjes si Import-Eksport-transport te mallrave industriale, ushqimore, materiale ndertimi, higjeno sanitare etj. dhe tregetimin e tyre.

Neni 5

Kohezgjatja e Shoqerise eshte fiksuar mbi dhjete vjet dhe mund te zgjatet ose te priset me perpara me vendim te ortakeve themelues.

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqeris, eshte percaktuar ne 100.000 (njqind mije) Leke. Ky kapital eshte nenshkruar dhe shlyer ne masen 100% nga ortaket themelues.



Neni 7

Viti financiar do te mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti. Viti i pare financiar do te mbyllet me 31.12.1998. Ortaket themelues kujdesen qe brenda kufijve dhe ne zbatim te normave ligjore te hartoje inventarin dhe bilancin te perbere nga gjendja pasurore, llogaria ekonomike dhe nga llogari plotesuese duke i shoqeruar ato me nje relacion mbi ecurine e administrimit te Shoqerise.

Mbi te ardhurat neto qe rezultojne nga bilanci i vitit financiar do te zbritet nje kuote jo me pak se 5% per t'u shenuar si rezerve ligjore.

Neni 8

Administrator i Shoqerise do te jete Z. Mitat Dule.

Qe nga ky çast vendoset qe te gjitha derdhjet e kapitalit te kryhen ne monedhe te vendit ashtu dhe fitimet dhe financimet eventuale te ardhshme, duhet te derdhen ne nje llogari qe do te hapet ne banke.

Neni 9

Shpenzimet dhe taksat e ketij akti, direkte apo indirekte, jane ne ngarkim te Shoqerise.

Neni 10

Kjo kontrate eshte hartuar ne Tirane ne 4 (kater) ekzemplare, duke patur te gjitha tekstet te njejten permbajtje dhe te njejten fuqi ligjore.

Lexuar, konfirmuar, nenshkruar dhe detyron ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES

Mitat DULE

Gazeli DULE

Mitat Dule